



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:114781
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05733363

Ac.nr.2374/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi - Saraçi, në çështjen kontestimore të paditëses M. K, me vendbanim në ..., Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit M. K avokat në Pejë, kundër të paditurës “L... “ SH.A., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit D. B, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1316/17 të datës 29.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e paditëses M. K, me vendbanim në ... Komuna e Pejës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1316/17 i datës 29.01.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit refuzohet si e pa bazuar, kërkesëpadia e paditëses M. K, me vendbanim në ..., Komuna e Pejës, me të cilën ka kërkuar që të: obligohet e paditura “L... “ SH.A., me seli në Prishtinë, që t'ia paguaj paditëses kompensimin e dëmit në shumën prej 4.650,00€, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 926,00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka kanë paraqitur ankesë paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i

atakuar dhe të aprovohet në tërësi kërkesëpapia e paditëses, apo i njëjti të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja M. K ka parashtruar padi ndaj të paditurës "L..." sh.a, me seli në Prishtinë, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj paditëses kompensimin e dëmit në shumen prej 4.650,00€, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 926,00€.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe atë: qarkullimi për llogari për periudhën 01.01.2010 - 08.11.2014 e lëshuar nga ..., propozimi për Përmbarrim i datës 21.06.2013, pasqyra bankare e lëshuar nga ... Prishtinë e datës 29.01.2013, procesverbali E.nr. 773/13, kërkesa për transferimin e lëndës tek Përmbarruesi Privat 02.12.2014, procesverbalet P.nr. 681/2014, i datës 20.07.2015, ekspertiza Financiare e ekspertit U. S e datës 13.01.2020, aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nën shenjën AC.nr. 300/2018, i datës 24.06.2019, shkresat tjera të lëndës C.nr. 1316/2017, si dhe deklarimi i dëshmitarëve: R. A, A. S, M. S e lindur K, Sh. B, e lindur S.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësja M. K (si kredimarrëse), nga ..., si përfaqësuese e N.T.P. "...", me datës 30.12.2011, ka lidhur Kontratë për Kredi Biznesi nr.07/2011 BS,006, me të paditurën L... sh.a. (kredidhenëse), për shumën prej 30.000€, me kamatë vjetore 18%, me afat të kthimit prej 36 muaj. Nga llogaria e kredi marrëses (këtu paditësja M.), me datë 04.01.2012, janë transferuar nga kredi dhënësja (këtu e paditura L...) 29.490€ (janë zbritur 1.7%, në emër të shpenzimeve të menaxhimit sipas kontratës, $30.000€ - 510€ = 29.490€$), dhe nga këto mjete paditësja shfrytëzon shumën prej 5.900€, ndërsa nga llogaria e "...", në emër të kredive të 7(shtatë) Xh. K - pagesa e kredisë K/439/2010BB006, shumën prej 3.779,69€, S. V-pagesa e kredisë K/136/2010BB006, shumën prej 2.493,96€, B. K - pagesa e kredisë K/146/2010BB006, shumën prej 2.663,95€, Sh. S, pagesa e kredisë K/257/2010BB006, shumën prej 2.116,91€, A. K - pagesa e kredisë K/508/2010BB006, shumën prej 5.040,85€, M. S - pagesa e kredisë K/674/2010BB006, shumën prej 4.472,10€, dhe P. M -pagesa e kredisë K/462/2010BB006, shumën prej 3.000,00€, e në shumen totale prej 23.567,46€.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e miraton kolegji i Gjykatës së Apelit dhe gjenë se aktgjykimi i ankimuar nuk ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilën gjë kolegji kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji gjithashtu ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete përse ka vendosur dhe çfarë ka marrë për bazë me rastin e vendosjes si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor. Arsyet e dhëna si në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i pranon në tërësi kolegji i Gjykatës së Apelit. Për këto shkaqe kolegji ka gjetur se është bërë edhe aplikimi i drejtë i të drejtës materiale.

Paditësja në pretendimet e saj gjatë seancave të zhvilluara dhe ato të parashtruara në ankesë, ka theksuar se e paditura pa konfirmimin e saj me shkrim ka bërë shlyerjen e kredive për klientët e tjerë të saj duke e dëmtuar kështu paditësen në vlerën e kërkuar si në kërkesëpadinë e parashtruar. Kolegji nuk i aprovon pretendimet ankimore të paditëses, për faktin se, nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se transferi i mjeteve monetare nga xhirollogaria e NTP “...” me datë 04.01.2012, tek personat, ka ndodhur pa vullnetin dhe nënshkrimin e paditëses. Kolegji gjithashtu gjen se palët në procesin civil duhet që të kenë legjitimitimin për të parashtruar një çështje në gjykatë ose për të kundërshtuar parashtrimin e palës tjetër, është e domosdoshme që ato të kenë interes të ligjshëm, e që në rastin konkret pala e paditur nuk ka legjitimitet pasiv, për faktin se sipas pretendimeve të paditëses, e njëjta ka qenë e mashtruar në selinë e ... në Skenderaj, nga personi i quajtur S., e që nga shkresat e lëndës nuk mund të shihet nëse paditësja rastin në fjalë ta ketë paraqitur rastin në organet e drejtësisë dhe që nga këto organe të jetë nxjerrë ndonjë vendim ku

do të vërtetohet përgjegjësia e ndonjë subjekti dhe me këtë të jetë krijuar baza për kompensim. Kolegji gjen se, te rastet e shpërblimit të dëmit duhet që të përmbushen kërkesat e përcaktuara për shpërblim e që janë: dëmi duhet që të ketë ndodhur, dëmi duhet që jetë shkaktuar nën përgjegjësinë juridike civile të dëmtuesit, duhet që të ekzistojë lidhja kauzale dhe duhet që të përcaktohet vëllimi i dëmit. Kolegji ka miratuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë që nga ekspertiza e ekspertit financiar se transferi nga llogaria e klientit nuk mund të bëhet pa urdhrin dhe nënshkrimin e klientit. Nga kjo kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se paditësja nuk ka arritur që të argumentojë ekzistimin e përgjegjësisë deliktore civile të të paditurës apo cilitdo nga personat të cilat kanë kryer shërbime për të paditurën.

Në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuar, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. Paditësja përveç kontestimit verbal, nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur. Në nenin 319.1 të LPK-së, është parashikuar që *secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*. Nga të gjitha këto që u parashtruan më lartë, rezulton se, nuk qëndrojnë thëniet ankimore të parashtruara nga ana e paditëses, këto thënie kanë mbetur vetëm në nivel të pretendimeve dhe si të tilla edhe janë refuzuar si të pa bazuara. Në një gjendje të tillë të çështjes, kolegji ka gjetur se duhet bërë refuzimi i pretendimeve ankimore të palës paditëse dhe që të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2374/2021 me datë 23.05.2024

Kryetari i kolegjit- gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj